



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 01, datë 24.11.2021

PËR
MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA
ROSKOVEC, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 4, DATË 10.06.2020,
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 4, datë 10.06.2020 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Roskovec”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Roskovec, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 76, datë 30.09.2021, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Roskovec të miratuar me Vendimin Nr. 4, datë 10.06.2020, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e:
 - *Rregullores së Planit:*
 - Në nenin 15 “Madhësia e Parcelës” pas pikës 6, shtohen pikat 7, 8 dhe 9;
 - Në nenin 30 “Rregulla kufizuese në zonat e reja për zhvillim” pas pikës 1, shtohen pikat 1.1 deri në 1.6;
 - Pas nenit 35 “Përcaktimi i njësive strukturore për të cilat hartohet PDV dhe PDZRK” shtohet neni 35/1 “Rastet për të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm”;
 - Në nenin 42 “Parametrat e zhvillimit për strukturat që lejohen në Nënkatëgoritë Banim dhe shërbime (A2)” bëhet ndryshim në pikën 11;
 - Në nenin 56 “Kushte për zhvillime në Kategorinë Varrezë (V)” pas pikës 8 shtohen pikat 9 deri në 12;
 - Në nenin 67 ndryshon titulli në “Kushte për zhvillime në Sistemin Bujqësor dhe Natyror”



dhe shtohen pikat 4.1 deri 4.5;

- Pas nenit 70 "Kushte për zhvillime në Kategorinë Infrastrukturë Bujqësore (IB)" shtohet neni 70/1 "Kanalet vaditëse/Emisaret";
- Në nenin 84 "Kushte për zhvillime në Sistemin Ujor" pas pikës 1, shtohen pikat 1.1 deri 1.3;
- Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore.

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Roskovec, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Roskovec dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Roskovec, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ERLIRANA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

~~BELINDA BALLUKU~~ 4.



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

~~LEDIA TOTA~~

